



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

*Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency*



# GJENDJA E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

sfidat dhe të arriturat për vitin 2020, ndikimi i  
pandemisë dhe dhënia e rekomandimeve për  
ngritjen e cilësisë në këtë sektor





# GJENDJA E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

sfidat dhe të arriturat për vitin 2020, ndikimi i  
pandemisë dhe dhënia e rekomandimeve për  
ngritjen e cilësisë në këtë sektor



**Mbështetur nga:**

Qaint

**Dizajn:**

Envinion

Prof.assoc. PhD. Ferdije Zhushi Etemi

Ky raport është mbështetur nga projekti Cilësia, Llogaridhënia, Integriteti dhe Transparenca në Arsimin e Lartë (ang.QAINT).

Projekti QAINT financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ang. ADA), me kontribut të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe zbatohet nga konsorciumi KEC, ORCA dhe ZSI.

# PËRMBAJTJA

1. STRUKTURA E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË.....	8
2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA).....	10
3. SIGURIMI I CILËSISË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.....	13
4. ARSIMI I LARTË NË KOSOVË NË VITIN 2020 .....	15
5. ORGANIZIMI I ARSIMIT TË LARTË NË KOHË TË PANDEMISË COVID-19 .....	24

“Arsimi nuk është përgaditja për jetë;  
arsimi është vet jeta.”

[John Dewey]

# SHKURTESAT

<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>ECTS</b>	European Credit Transferring System
<b>ENQA</b>	Rrjeti Evropian i Sigurimit të Cilësisë
<b>EQAR</b>	Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë
<b>ESG</b>	Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë
<b>EHEA</b>	Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë
<b>IAL</b>	Institucion i Arsimit të lartë
<b>KSHC</b>	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
<b>KKK</b>	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
<b>TI</b>	Teknologjia informative
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ

# 1. STRUKTURA E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Arsimi i lartë paraqet nivelin më të lartë të edukimit. Prandaj roli i tij është të nxisë zhvillimin e dijes, mendimin kritik, hulumtimin dhe inovacionin nëpërmjet të cilave përgatit profesionistë të fushave përkatëse por edhe qytetarë të denjë, përgjegjës për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit. Përgjegjëse për rregullimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Në aspektin legjislativ, arsimi i lartë në Kosovë rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011)<sup>1</sup>. Sipas nenit 4 të këtij ligji, arsimi i lartë ka si qëllim:

- krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore;
- përgatitjen e studentëve për studime të mëtejshme, praktikë profesionale dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, me anë të përvetësimit dhe zhvillimit të njohurive të thelluara dhe kompetencave të nivelit të lartë;
- ofrimin e mundësive për të gjithë banorët e Kosovës që janë të aftë për të përfituar nga ky arsimim dhe për t'i kontribuar shoqërisë dhe vendit të tyre gjatë gjithë jetës së tyre.

---

<sup>1</sup> . Ligji për Arsimin e Lartë <https://www.masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>



Kosova implementon sistemin e arsimit të lartë në përputhje me Procesin e Bolonjës<sup>2</sup>, i cili u prezantua në Evropë në vitin 1999 dhe ndikoi në krijimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Ky proces solli reforma të thella në sistemet e arsimit të lartë në tërë Evropën dhe si i tillë u pranua edhe nga Kosova në vitin 2001. Sipas modelit të Bolonjës, arsimi i lartë në Kosovë ofrohet në 3 nivele:

- 1** Niveli i parë - 3-4 vite studimi që përfundojnë me 180, gjegjësisht 240 ECTS. Në përfundim të studimeve fitohet diploma/gradë bachelor.
- 2** Niveli i dytë i studimeve - pas përfundimit të nivelit të parë bachelor, zgjat 1 deri 2 vite studimi, dhe përfundon me 60, respektivisht 120 ECTS. Në përfundim të studimeve fitohet diploma/gradë Master.
- 3** Niveli i tretë - programe të studimeve të doktoratës me karakter akademik dhe hulumtues/shkencor të pavarur, pas përfundimit të dy niveleve të para në të cilat janë akumuluar 300 ECTS. Këto studime zgjasin së paku tri vite dhe përfundojnë me marrjen e diplomës/gradës PhD ose Dr.sc.

Gjithashtu, si kualifikim i arsimit të lartë mund të konsiderohet çdo arsimim tjetër pas shkollës së mesme në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS).

Në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)<sup>3</sup> nivelet e arsimit të lartë përfshijnë nivelin 5, 6, 7 dhe 8.

<sup>2</sup> The Bologna Declaration of 19 June [http://www.magna-charta.org/resources/files/BOLOGNA\\_DECLARATION.pdf](http://www.magna-charta.org/resources/files/BOLOGNA_DECLARATION.pdf)

<sup>3</sup> [https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza\\_kombetare\\_e\\_kualifikimeve.pdf](https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_kombetare_e_kualifikimeve.pdf)

## 2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci publike, e pavarur, e cila bën akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë. AKA u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në vitin 2008 në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë Nr. 2003/14. Baza ligjore për aktivitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011) dhe Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018).

AKA përbëhet nga struktura administrative e saj, e cila udhëhiqet nga Drejtori i AKA-së, dhe nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i cili është organ qeverisës dhe vendimmarrës. Struktura administrative e AKA-së momentalisht ka të punësuar Drejtorin dhe 8 zyrtarë. Përpos Ligjit të Arsimit të Lartë, MASHTI ka hartuar një Udhëzim të veçantë Administrativ për Kriteret dhe Procedurat e Përzgjedhjes së anëtarëve të KSHC-së (Nr. 05/2018, dt.15.03.2018), ndërsa puna e KSHC-së bazohet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Nr. 621/18D, dt.12.06.2018).

Gjendja e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka ndikuar edhe në ndryshimin dhe riorganizimin e punës së AKA-së në përputhje me rrethanat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Duke u bazuar në këto rrethana, KSHC në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2020 mori vendim që Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) të zhvillojë procesin e akreditimit në distancë. Vendimi përfundimtar për lejimin e organizimit të procesit të akred-

itimit në distancë u aprovua nga ish-ministrja e Arsimit, Hykmete Bajrami. (Ref: 35/018 Dat:07.05.2020). Ky vendim rregullon procedurat e vlerësimit të jashtëm nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës, gjatë periudhës në të cilën janë në fuqi masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 1.2 të vendimit Nr.01/07, të datës 11.03.2020, me qëllim të menaxhimit të rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19.

AKA fillimisht filloi me organizimin në distancë të akreditimit institucional të institucioneve të arsimit të lartë, i cili u zhvillua duke shqyrtuar praktikat më të mira të akreditimit në rajon dhe në Evropë gjatë situatës së jashtëzakonshme të pandemisë. Pas përfundimit të suksesshëm të vlerësimit në distancë në nivel institucional, në fazën e dytë të procesit, prej muajit korrik 2020 e tutje, AKA vazhdoi me vlerësimin e programeve të studimit në fushat e mjekësisë, ekonomisë dhe të juridikut.

Në vitin 2020, AKA realizoi vlerësimin institucional të 14 IAL-ve, prej të cilëve 5 ishin universitete publike ndërsa 9 prej tyre ishin kolegje private. Nga gjithsej 14 institucione të vlerësuara, mbi bazën e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë, 6 nga këto institucione u riakredituan, ndërsa 8 të tjera u refuzuan për riakreditim institucional. Në procesin e vlerësimit të programeve të studimit, AKA vlerësoi 29 programe nga fushat e lartëcekura.

Realizimi me sukses i procesit të akreditimit në kohë të pandemisë COVID-19, është një arritje për AKA-në pasi ky proces u bazua në praktikat më të mira evropiane për vlerësim në distancë dhe gjithashtu mundësoi vazhdimin e vlerësimit periodik të institucioneve dhe të programeve. Përpos realizimit me sukses të vlerësimit të jashtëm në distancë, gjatë vitit 2020 ka pasur intensifikim të aktiviteteve të AKA-së që kanë rezultuar me hartimin e dokumenteve të rëndësishme, siç janë:

- Plani Strategjik i AKA-së;
- Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës;
- Manuali për Ekspertët e jashtëm.

Aktivitet tjetër me rëndësi në vitin 2020, është edhe funksionalizimi i Komisionit të Ankesave.

Megjithatë sfidat me të cilat përballet AKA për funksionimin e saj të suksesshëm janë:

- tendenca për ndërhyrje politike në AKA dhe cënimi i pavarësisë së saj;
- mos aprovimi i Ligjit për AKA-në;
- përmbushja e rekomandimeve të dhëna nga ENQA me qëllim të riaplikimit dhe rikthimit të AKA-së në këtë institucion;
- ngritja e kapaciteteve humane të AKA-së;
- sigurimi i hapësirës më të madhe për funksionimin e AKA-së; si dhe
- përfshirja e studentëve në KSHC dhe në ekipet e ekspertëve.

# 3. SIGURIMI I CILËSISË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Sigurimi i cilësisë në IAL përfshinë një varg aktiviteteve dhe procesesh që nënkuptojnë përfshirjen e të gjithë faktorëve dhe marrjen e përgjegjësisë të secilit prej tyre në arritjen e qëllimit të përbashkët, përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Përgjegjësia dhe përmirësimi janë dy çështje esenciale për sigurimin e cilësisë të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin e një kulture për cilësi e cila do të forconte besimin e publikut të gjerë në IAL-të dhe në cilësinë e programeve që ato ofrojnë.

Janë një mori standardesh për sigurimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të cilat janë të matshme dhe përdoren si indikatorë për vlerësimin e tyre. Konferenca ministrore në Yerevan<sup>4</sup> (2015) në të cilën u aprovuan Standardet dhe Udhëzuesit e rishikuar Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG), potencoi edhe një herë rolin e këtyre standardeve për të kuptuar sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përfshirë edhe mjedisin e të mësuarit dhe lidhjen e tij me hulumtimin dhe inovacionin, janë në fokus të këtyre standardeve.

Sipas ESG-ve, përgjegjësia për sigurimin e cilësisë bie mbi vetë institucionet e arsimit të lartë të cilat duhet të sigurojnë studentët, punëdhënësit dhe publikun e gjerë se ofrojnë studime cilësore dhe shërbime për komunitetin. Që nga themelimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), të gjitha IAL-të kanë të themeluara njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat bartin edhe përgjegjësitë për akreditimin dhe riakreditimin e

<sup>4</sup> [https://www.ehea.info/media/ehea.info/file/2015\\_Yerevan/72/7/European\\_Standards\\_and\\_Guidelines\\_for\\_Quality\\_Assurance\\_in\\_the\\_EHEA\\_2015\\_MC\\_613727.pdf](https://www.ehea.info/media/ehea.info/file/2015_Yerevan/72/7/European_Standards_and_Guidelines_for_Quality_Assurance_in_the_EHEA_2015_MC_613727.pdf)

programeve që ofrojnë. Megjithatë, njësitet për Sigurimin e Cilësisë në IAL duhet të zhvillohen vazhdimisht me qëllim të arritjes sa më të kënaqshme të implementimit dhe promovimit të standardeve të cilësisë. Themelimi formal i njësive për Sigurimin e Cilësisë në IAL-të në Kosovë si dhe zhvillimi i Rregulloreve për Sigurim të Cilësisë mund të konsiderohet si një arritje në këtë drejtim. Vlerësimi periodik i IAL-ve nga AKA mundëson vlerësimin e nivelit të përmbushjes së standardeve të cilësisë në IAL, me ç'rast vihet në dukje edhe efikasiteti i njësive për Sigurim të Cilësisë.

Sidoqoftë, shumë sfida mbesin në këtë drejtim, ndër të cilat veçojmë: trajnimet e stafit të njësive për sigurimin e cilësisë për njohjen e ESG-ve (Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë), rritja e përfshirjes së stafit dhe studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë, transparenca e IAL-ve për rezultatet e sigurimit të cilësisë, transparenca e IAL-ve për rezultatet e procesit të akreditimit, përkatësisht publikimi i raporteve të vlerësimit nga AKA me qëllim të informimit të studentëve, etj.

Për të arritur një efikasitet më të kënaqshëm të njësive për Sigurimin e Cilësisë, të cilat duhet të shtyjnë përpara proceset zhvillimore të IAL-ve, rekomandohet që Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) të organizojë në mënyrë të vazhdueshme konferenca dhe seminare me tema relevante ku do të përfshihen të gjitha IAL-të. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve AKA do të mund të identifikojë vështirësitë e IAL-ve në përmbushjen e standardeve të aprovuara të AKA-së. Një mënyrë tjetër e aftësimin profesional të stafit të njësive për sigurimin e cilësisë është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar me institucione të arsimit të lartë nga vendet evropiane me një traditë dhe kulturë të zhvilluar në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

# 4. ARSIMI I LARTË NË KOSOVË NË VITIN 2020

Arsimi i lartë në vitin 2020 është ofruar nga 9 institucione publike dhe 22 institucione private. Nga 9 institucionet publike, 6 prej tyre janë Universitete, 1 është Universiteti i Shkencave të Aplikuara, 1 Fakultet dhe 1 Akademi. Në kuadër të IAL-ve publike nuk është përfshirë Universiteti i Mitrovicës i cili nuk i nënshtrohet legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.


Numri i IAL-ve private në vitin 2020 ka ndryshuar, prej 22 në 14, për shkak se 8 kolegje private nuk arritën të riakreditohen në nivel institucional, kështu që ato humbën të drejtën për të regjistruar studentë të ri në vitin akademik 2020/21.

Ky numër i IAL-ve që ofrojnë kualifikime të arsimit të lartë, padyshim se është shumë i madh krahasuar me numrin e banorëve të Kosovës. Synimi i klasës politike për ta rritur përfshirjen në arsimin e lartë pas vitit 2000, rezultoi me një ekspansion të IAL-ve private në Kosovë. Më vonë kjo dukuri ndodhi edhe në sektorin publik, në të cilin numri i universiteteve u rrit nga 1 sa ishte deri në vitin 2010, në 7 që funksionojnë aktualisht. Rritja e numrit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë ka ndikuar në rritjen e përfshirjes së të rinjve të moshës 18-22 në këtë sektor dhe ka bërë që sot Kosova të ketë përfshirjen në arsimin e lartë me rreth 73%, që njëherazi është përfshirja më e lartë në Evropë.

Në vitin 2019, numri i studentëve në arsimin e lartë ka shënuar shifrën prej



122,000  
STUDENTËVE



duke e vënë  
Kosovën në krye të  
vendeve evropiane

ME 6,669 STUDENTË PËR 100,000 BANORË.

Në anën tjetër, shkalla e diplomimit të studentëve në raport me numrin e atyre të regjistruar është mjaft e vogël. Sipas shënimeve nga Agjencia e Statistikave të Kosovës<sup>5</sup>, në vitin akademik 2019/2020 numri total i studentëve në IAL-të publike ishte 59.934, kurse në IAL-të private ishin raportuar 14.787 studentë. Meqenëse mungojnë shifrat për disa kolegje private, numri definitiv i studentëve në sektorin privat nuk mund të konsiderohet i saktë.

Padyshim, kjo rritje dhe ky masivizim ka ndikuar negativisht në cilësinë e arsimit të lartë duke pasur parasysh numrin e vogël të stafit të kualifikuar akademik, mungesën e kapaciteteve kërkimore-shkencore në vend dhe aftësinë e tregut të punës për të absorbuar të diplomuarit. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, (PSAK)<sup>6</sup> i hartuar nga MASHTI, ka si objektivi strategjik Arsimin e Lartë dhe si prioritet kryesor në këtë fushë ka vendosur përmirësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

Të dhënat ekzistuese për përqindjen e studentëve që studiojnë në IAL-të publike dhe private<sup>7</sup> në Kosovë tregojnë se rreth 52.1% e studentëve ndjekin studimet në shkencat shoqërore - biznes dhe drejtësi, 12.3% në shkencat teknike - inxhinieri, 9.7% në shkencat humane dhe arte, 7.1% në

5 Statistikat e Arsimit 2019/20 [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/statistikat-e-arsimit-2019-2020\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/statistikat-e-arsimit-2019-2020_1.pdf)

6 . [https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)

7 [https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)



shkencat mjekësore, 6.8% vijojnë studimet në edukim, 6.7% në shkencat e natyrës, matematikë dhe kompjuterikë, 2% në bujqësi dhe veterinë, dhe 3% të tjerë në shërbime.

Këto të dhëna flasin për një mungesë koordinimi dhe planifikimi të zhvillimit të arsimit të lartë me nevojat e tregut në vend. Meqenëse, aktualisht nuk ka ndonjë analizë të mirëfilltë për nevojat e tregut të punës për kuadro profesionale të fushave të caktuara të arsimit të lartë, është e vështirë të planifikohet zhvillimi i programeve të reja konform kërkesave të tregut.

Bazuar në gjendjen ekzistuese, mund të konstatohet se zhvillimet në këtë standard janë akoma në fazat fillestare dhe duhet shumë përpjekje nga të gjitha palët (MASHTI, ministritë tjera relevante, institucionet e arsimit të lartë, punëdhënësit) për ta jetësuar lidhjen e kualifikimeve me kërkesa e tregut të punës në vend.

Megjithëse ka disa iniciativa në këtë fushë, siç është themelimi i bordeve të punëdhënësve në disa IAL, akoma mbesin sfida që duhet të adresohen, sikurse:










- Qasja serioze dhe përkushtimi i palëve përgjegjëse për të sjellë ndryshime;
- Analiza e mirëfilltë dhe profesionale e kërkesave të tregut të punës në vend nga institucionet shtetërore;
- Gatishmëria e bizneseve/punëdhënësve për bashkëpunim;
- Gatishmëria e IAL-ve që herë pas here ti rishikojnë programet ekzistuese dhe ti ndryshojnë ato konform nevojave të tregut;
- Hartimi i programeve të reja të studimit që nxisin krijimin e vendeve të punës.

Për të sjellë ndryshime dhe progres në këtë aspekt, rekomandohet që MASHTI të bartë përgjegjësitë për caktimin e fushave prioritare të arsimit të lartë dhe caktimin e kuotave të studentëve për fusha të studimit, pastaj të promovohet përfshirja e punës praktike/internshipit në programet e studimit dhe si dhe të bëhet alokimi i ECTS kredive për punë praktike,

të sigurohet punësimi i të diplomuarve në kompanitë në të cilat e bëjnë punën praktike, të motivohet themelimi i IAL-ve të shkencave aplikative që do të lidhen drejtpërsëdrejti me industrinë, etj.

Sa i përket programeve të studimit, sipas shënimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në vitin 2020, 234 programe të studimit janë ofruar nga IAL-të publike (në nivelin Bachelor, Master dhe PhD (vetëm në Universitetin e Prishtinës), kurse IAL-të private kanë ofruar 128 programe të akredituara në nivelin Bachelor dhe Master. Përkundër zhvillimit ekonomik të ultë dhe të ngadalshëm të vendit, analiza e tregut të punës është e domosdoshme para se të zhvillohen programe të reja studimi në IAL.

**Tabela 1.** Numri i programeve të akredituara në Institucionet publike të Arsimit të lartë të Kosovë

Nr.	Institucioni		Numri i programeve të akredituara 2020
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"		156
2	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"		20
3	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"		14
4	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"		20
5	Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"		10
6	Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"		3
7	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj		9
8	Fakulteti i Studimeve Islame		2
9	Akademia e Sigurisë publike		1
<b>Gjithsejtë</b>			<b>234</b>

**Tabela 2.** Numri i IAL privat të akredituar në Kosovë, në vitin 2020

Nr. Institucioni	Numri i programeve të akredituara 2020
1 Kolegji AAB	48
2 Kolegji UBT	39
3 Kolegji Rezonanca	8
4 Kolegji Heimerer	6
5 Kolegji Universum	6
6 Kolegji Riinvest	5
7 Kolegji Dardania	4
8 Akademia Evolucion	4
9 Kolegji IBCM	4
10 Kolegji AUK	3
11 Kolegji ESLG	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>128</b>

Sa i përket stafit akademik, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në një IAL paraqet një kriter të rëndësishëm të cilësisë. Sipas të dhënave të ASK, në IAL-të publike në vitin akademik 2019/20 numri i stafit akademik në marrëdhënie të rregullt pune ishte 1297, dhe përveç këtyre ishin edhe 761 staf i angazhuar dhe 44 staf nga jashtë shtetit. Në kolegjet private në këtë vit akademik, numri i stafit akademik në marrëdhënie të rregullt pune ishte 668, kurse i atyre të angazhuar ishte 293. Krahasuar me numrin e lartë të studentëve në nivel vendi, këto shifra të stafit akademik

janë tejet të ulëta dhe flasin për një mungesë të theksuar të politikave qeveritare dhe planeve zhvillimore në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë për zhvillimin e stafit akademik.

Rritja e numrit të IAL-ve në vend ka rritur edhe kërkesat për staf akademik me gradën Doktor, sidomos për faktin se AKA kërkon nga tre mësimdhënës me gradën Dr. për çdo program të vlerësuar të nivelit Bachelor dhe dy mësimdhënës më gradën Dr. për çdo program Master. Si rezultat i numrit të vogël të stafit akademik në vend, kjo kërkesë e AKA-së ka shkaktuar rritjen e konkurrencës ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për të siguruar stafin e duhur dhe njëherit ka shkaktuar një devalvim të vlerës së gradave dhe thirrjeve akademike, të cilat jo gjithmonë kanë bartur cilësi në vete. Në këtë disproporcion në mes të numrit të IAL-ve dhe stafit akademik ka ndikuar edhe hapja e universiteteve të reja publike, të cilat filluan punën me stafin e huazuar të Universitetit të Prishtinës, por edhe sot, pas disa vitesh veprimtari, zhvillimi i kapaciteteve vetanake me staf po shkon ngadalë dhe me vështirësi. Në shumicën e IAL-ve në vend mungojnë planet për zhvillimin e stafit, me të cilin duhet të planifikohet numri i stafit akademik për një periudhë disavjeçare. Sfidë gjithashtu mbetet rritja e numrit të stafit akademik në IAL me qëllim të përmirësimit të raportit staf:studentë, i cili aktualisht është larg standardeve evropiane.

Sa i përket punës kërkimore-shkencore, edukimi dhe zhvillimi i kërkimit shkencor janë dy misionet kryesore të IAL-ve, prandaj Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) sugjerojnë që hulumtimi shkencor të përfshihet në vlerësimin e IAL-ve, së bashku më të gjitha aktivitetet tjera. Në Kosovë veprimtaria kërkimore-shkencore në nivel të vendit në aspektin legjislativ rregullohet më Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore. Përpos këtyre dy akteve bazike, IAL-të e rregullojnë veprimtarinë e tyre shkencore përmes Statutit dhe rregulloreve të tjera të brendshme. Veprimtaria kërkimore-shkencore e IAL-ve është pjesë e Planeve Strategjike Zhvillimore të IAL-ve, kështu që Universitetet të cilat kanë në misionin e tyre edhe aktivitetin shkencor, kanë hartuar Strategji të Hulumtimit Shkencor për periudha të caktuara kohore. Komuniteti akademik në çdo institucion të arsimit të lartë është përgjegjës për zhvillimin e kriterëve të

Etikës në hulumtim për të garantuar cilësi të hulumtimit shkencor si dhe për të parandaluar shkeljet e mundshme të integritetit akademik.

MASHTI gjithashtu ka hartuar Udhëzimin Administrativ 01/2018 mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, përmes së cilit synon nxitjen e publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare shkencore me recension në platforma të caktuara. Përkundër kësaj iniciative, duhet cekur se disa nga platformat e propozuara nga MASHTI në këtë UA nuk sigurojnë cilësinë e duhur të punimeve shkencore të publikuara nga stafi akademik në IAL-të e Kosovës.

Megjithëse është shënuar një ngritje e numrit të punimeve shkencore të publikuara në revistat e indeksuara në Web of Science dhe Scopus në Universitetin e Prishtinës, si institucioni më i madh i arsimit në vend, arritjet në kërkimin shkencor në arsimin e lartë janë ende mjaft modeste dhe nuk mund të konkurrojnë me shtetet evropiane. Numri i publikimeve shkencore për staf akademik në shumicën e IAL-ve është i vogël, madje ka mësimdhënës që nuk kanë publikuar asnjë punim. Financimi aktual i kërkimeve shkencore nuk është motivues për personelin akademik të IAL-ve për të nxitur zhvillimin e shkencës. Gjithashtu infrastruktura e nevojshme laboratorike për realizimin e hulumtimeve shkencore është e limituar dhe larg standardeve të duhura.

Investimi në zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike dhe zhvillimin e kapaciteteve humane për tu marrë me kërkime shkencore është mënyra më e mirë për të ngritur aktivitetin kërkimor-shkencor në IAL-të. MASHTI përkrahë punën shkencore të IAL-ve nëpërmjet financimit të projekteve të vogla shkencore në të cilat aplikon personeli akademik. Propozimet e projekteve vlerësohen nga Këshilli Shkencor i Ministrisë i cili është i përbërë prej 7 anëtarëve. Mirëpo financimi i punës shkencore nuk është domethënës dhe nuk ka ndikim në rritjen e rezultatit shkencor të vendit. Prandaj, rekomandohet që MASHTI të shtojë përkrahjen për stafin e ri akademik të universiteteve dhe kolegjeve në zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive kërkimore-shkencore duke i mundësuar qëndrimin me karakter hulumtues në universitete prestigjioze evropiane dhe botërore, duke iu mundësuar pjesëmarrje në mobilitete akademike apo duke i finan-

“Rritja e numrit të IAL-ve në vend ka rritur edhe kërkesat për staf akademik me gradën Doktor, sidomos për faktin se AKA kërkon nga tre mësimdhënës me gradën Dr. për çdo program të vlerësuar të nivelit Bachelor dhe dy mësimdhënës me gradën Dr. për çdo program Master. Si rezultat i numrit të vogël të stafit akademik në vend, kjo kërkesë e AKA-së ka shkaktuar rritjen e konkurrencës ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për të siguruar stafin e duhur dhe njëherit ka shkaktuar një devalvim të vlerës së gradave dhe thirrjeve akademike, të cilat jo gjithmonë kanë bartur cilësi në vete.”

cuar ata në studime doktorale ose pas doktorale në universitete me arritje të larta në shkencë.

Infrastruktura e mjaftueshme, cilësore dhe e sigurtë në institucionet e arsimit të lartë është parakusht për krijimin e një mjedisi të mësimnxënies i cili do t’iu mundësojë studentëve arritjen e rezultateve të planifikuara të të nxënit. Në këtë mjedis duhet të sigurohet një qasje e barabartë për të gjithë studentët, pa marrë parasysh nivelet e ndryshme të përgatitjes paraprake. Në veçanti, IAL-të duhet t’iu mundësojnë qasje të sigurtë në hapësirat fizike të institucionit personave me aftësi të kufizuara.

Në rast të mësimin në distancë/virtual, siç ishte në kohë të masave emergjente për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, IAL-të që aktualisht veprojnë në vend iu mundësuan studentëve qasje në një mjedis mësimor më ndryshe, mjedis mësimor digjital nëpërmjet platformave të ndryshme elektronike. Megjithatë, mbetet sfida se sa ishin të mbrojtur studentët në aspektin e privatësisë gjatë komunikimit digjital nëpërmjet internetit, pasi që IAL-të duhet të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave dhe të gjitha masat tjera.

Në IAL-të në Kosovë, mjedis i të mësuarit janë ambientet fizike: klasat, diku me pajisje mjaft modeste e diku më të avancuara, laboratorët, bibliotekat e fakulteteve/universiteteve si dhe ambientet jashtë IAL-ve që shfrytëzo-

hen nga studentët, siç është Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Sa i përket pajisjes me literaturë prej të cilave studentët mund të mësojnë, numri i teksteve mësimore adekuate për programet që ofrohen në IAL, ndryshon nga institucioni në institucion. Pajisja me tekste mësimore që përdoren në kurse gjatë ligjërimit mbetet një sfidë edhe më tej, pasi që universitetet nuk ndajnë fonde për blerjen e librave. Kjo gjithashtu ndikon që disa mësimdhënës në IAL-të në të dy sektorët, edhe sot të përdorin literaturë tejet të vjetërsuar dhe jo aktuale për zhvillimet ekonomike dhe sociale, si dhe ato shkencore dhe teknologjike në nivel global. Përveç literaturës fizike, IAL-të duhet t'iu mundësojnë studentëve qasje elektronike në literaturë, një element mjaft sfidues në nivel të vendit.

Infrastruktura mësimore, klasat dhe laboratorët, në sektorin publik të arsimit të lartë në shumë raste është e vjetruar dhe jo e mirëmbajtur, gjë që mund të sjellë demotivim për studentët. Mungesa e stafit teknik për mirëmbajtje të pajisjeve laboratorike në universitete ka ndikuar që shpesh, për shkak të një prishjeje të vogël, pajisja të mbetet jashtë përdorimit. Në kohë të fundit janë vërejtur përpjekjet për një furnizim më të mirë të laboratorëve në universitete publike me aparaturë të duhur, mirëpo laboratorët e akredituar, në të cilat mund të realizohen hulumtime shkencore më të avancuara ende janë të pakta.

Gjatë kohës së pandemisë COVID-19 në Kosovë u vërejt mungesa e theksuar e stafit profesional dhe laboratorëve të pajisura me pajisje bashkëkohore të avancuar (PCR) që do të përkrahnin Ministrinë e Shëndetësisë në luftimin e pandemisë.

Meqenëse financimi i arsimit të lartë publik bëhet nga buxheti i shtetit, përmbushja e shumë kërkesave që adresohen nga IAL-të është shumë e ngadalshme dhe ndonjëherë edhe neglizhohet fare. Rekomandohet që MASHTI të bëjë financimin e IAL-ve në bazë të fushave që i ofrojnë, pasi që fushat e caktuara (mjekësia, shkencat e natyrës, inxhinieria, teknologjia informative dhe ajo e ushqimit, bujqësia dhe veterina, farmacia, artet, etj.), kërkojnë hapësira dhe pajisje më të kushtueshme, në krahasim me fushat shoqërore dhe ato humane.

# 5. ORGANIZIMI I ARSIMIT TË LARTË NË KOHË TË PANDEMISË COVID-19

Viti 2020, pa asnjë dyshim, ishte vit i ndryshimeve të imponuara në arsimin e lartë kudo në botë, por dhe në vendin tonë. Pandemia COVID-19 që përfshiu botën dhe vendin, detyroi Qeverinë e Republikës së Kosovës në marrjen e masave të kufizimit të lëvizjes së lirë dhe mbylljen totale të vendit në muajin mars. Për t'iu përgjigjur rrethanave të reja të krijuara, institucionet e arsimit të lartë reagues me shpejtësi dhe ndërmorën gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.

Për një kohë shumë të shkurtë, të gjitha IAL-të në vend reagues ndaj kërkesave për ndryshimin e mënyrës së ofrimit të mësimin prej formës së kontaktit kokë më kokë në formë digjitale, respektivisht në distancë. Koha e shkurtë për ndryshime dhe kërkesa për të vazhduar mësimin shpejtë, nuk la mundësi për ofrimin e trajnimeve lidhur me vendosjen e përmbajtjes së lëndës në platformë digjitale, duke pasur parasysh se përvoja e mësimdhënësve në përdorimin e TI-së ishte e ndryshme. Megjithatë infrastruktura ekzistuese e TI-së në shumicën e IAL-ve ishte e mjaftueshme për përkrahjen e organizimit të mësimin në distancë në kushte të pandemisë.

Në anën tjetër, sfidë evidente ishte pajisja e studentëve me pajisje teknologjike në kushte shtëpie. Ani pse Kosova njihet si shtet me shtrirje të mirë të rrjetit të internetit, ku vlerësohet se 76.6% e popullsisë së Kosovës janë përdorues të tij, qasja në internet me shpejtësi të lartë që mundësonte kyçje të lehtë në platforma digjitale si dhe pajisja me teknologji ishte sfiduese duke ditur gjendjen ekonomike-sociale në vend.



Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka realizuar dy procese të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë gjatë masave kufizuese të imponuara nga pandemia COVID-19 në përputhje me vendimin e MASHTI. Procesi i vlerësimit u realizua në distancë përmes platformave digjitale, ndërsa koordinimi nga stafi i AKA-së u bë në formë fizike. Format i takimeve në mes të përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë dhe ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit nuk ndryshoi nga agjenda e takimeve fizike dhe në asnjë rast për dy vite radhazi nuk u raportua ndonjë pengesë e cila do të pamundësonte realizimin e procesit të vlerësimit. Gjatë proceseve të vlerësimit të dy viteve të fundit, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit adresuan çështjen e pandemisë COVID - 19 dhe vlerësuan menaxhimin e procesit mësimor si dhe sistemin e sigurimit të cilësisë edhe në kushte të pandemisë. Në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë vizitave online si dhe në bazë të raporteve të vlerësimit, AKA mund të konstatojë se institucionet e arsimit të lartë kanë arritur me sukses të bëjnë një transformim të shpejtë të mësimin nga forma fizike në atë digjitale dhe të tejkalojnë pengesat teknike. Megjithatë, një vlerësim më substancial sa i përket monitorimit të procesit mësimor, vlerësimit të përshtatshmërisë së përdorimit të platformave elektronike nga studentët dhe stafi, si dhe ndryshimet përmbajtësore që IAL-të i kanë integruar me qëllim të përmirësimit të mësimin online nuk është arritur gjatë vizitave online të akreditimit. Prandaj, për të bërë një analizë të bazuar në dëshmi në lidhje me sfidat e arsimit të lartë në Kosovë gjatë kushteve të pandemisë, AKA ka realizuar një pyetësor elektronik me përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë. Në pyetësorin e përgatitur janë pranuar përgjigje nga 15 institucione të arsimit të lartë, të cilët kanë vënë në pah sfidat kryesore të cilat mund të përmbliidhen si në vijim:

- Adaptimi i shpejtë i mësimdhënies në formën elektronike dhe mungesa e njohurive të mira nga stafi për përdorim të platformave elektronike;
- Problemet teknike të lidhura me qasjen në internet nga studentët, mungesa e pajisjeve teknologjike personale të studentëve, menaxhimi i shumë sesioneve online në të njëjtën kohë, përgatitja e shumë materialeve udhëzuese në një kohë të shkurtë etj.;

- Interaktiviteti i ulët gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve;
- Mungesa e përkushtimit dhe pjesëmarrja e ulët e studentëve në ligjëratat;
- Vështirësitë për realizimin e punës praktike dhe ushtrimeve laboratorike;
- Realizimi i vlerësimit të studentëve në formën online;
- Kufizimi i stafi akademik dhe studentëve për punën kërkimore.

Përkundër gjendjes emergjente të shkaktuar nga pandemia e cila obligoi të gjitha institucionet e vendit në respektimin e masave të shpallura nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik për parandalimin e përhapjes së sëmundjes, IAL-ve iu mundësua që vetë të vendosin për mënyrën e organizimit të procesit mësimor-shkencor. Nga 15 institucionet të cilët janë përgjigjur në pyetësor, 11 prej institucioneve kanë deklaruar se kanë përdorur platformën Google Meet, ndërsa pjesa tjetër kanë deklaruar se kanë përdorur platforma të tjera sikurse Zoom, Moodle, Coursera, Edx, etj. Prej institucioneve të cilat kanë deklaruar se kanë përdorur platformën Google Meet, shumica e tyre kanë deklaruar se e kanë integruar atë me sistemin e brendshëm të menaxhimit të procesit mësimor. Sa i përket monitorimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor online dhe monitorimit të realizimit të tij, shumica e institucioneve kanë deklaruar se Rektori, Pro Rektoret për Mësim, Dekanët dhe Zyra e Cilësisë kanë monitoruar vazhdimisht mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në formën online përmes raporteve të gjeneruara nga platformat të cilat kanë lejuar evidentimin e qasjes së studentëve në klasat virtuale si dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të klasës virtuale.

Praktikat nga universitetet evropiane tregojnë për një rol të theksuar të njësisë për sigurimin e cilësisë në IAL në kohë të pandemisë COVID-19, të cilat luajnë rol aktiv në proceset e zhvillimit strategjik të institucioneve, zhvillimit të proceseve të vendimmarrjes dhe zhvillimit të stafit akademik. Sigurimi i cilësisë së programeve të ofruara në distancë, përfshirja e stu-

dentëve, përkujdesja për cilësinë e të mësuarit dhe ofrimi i shërbimeve për studentë janë disa nga angazhimet me prioritet për të cilat IAL-të duhet të përkujdeseshin në kohën e organizimit të mësimit në kushte emergjente të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Në pyetjen se a kanë realizuar Zyrat e Sigurimit të Cilësisë ndonjë vlerësim për mësimin online, 11 institucione kanë deklaruar që kanë realizuar vlerësim të mësimit online, ndërsa 4 prej tyre nuk kanë realizuar vlerësim. Vetëm në dy raste, institucionet kanë deklaruar që raporti i vlerësimit të mësimit online është publikuar në ueb faqen institucionale, ndërsa në të gjitha rastet e tjera raportet nuk janë të publikuara dhe janë hartuar vetëm për shërbim të brendshëm të institucionit. Në pyetjen se cilat janë gjetjet kryesore të vlerësimeve të tilla apo sfidat të cilat janë raportuar nga stafi dhe studentët, mund të kuptohet se përgjithësisht studentët nuk kanë qenë të kënaqur me mbajtjen e mësimit në formë elektronike. Disa prej sfidave kryesore të evidentuara gjatë vlerësimit të mësimit online nga IAL-të, janë raportuar problemet teknike që lidhen me qasjen në internet dhe në teknologji, mungesa e interaktivitetit gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve mes stafit akademik dhe studentëve si dhe vështirësia e ligjërimit të lëndëve praktike dhe realizimi i punës praktike nga studentët.

Gjatë masave emergjente të shkaktuara nga pandemia COVID-19, gjithë stafi akademik i IAL-ve tregoi gatishmëri të plotë për adaptimin e mënyrës së mësimit prej atij fizik në formë digjitale, pa marrë parasysh njohuritë paraprake për përdorimin e teknologjisë informative. Megjithatë, një tjetër sfidë mbetet se sa ishte adekuate teknika e ligjërimit me përmbajtjen e ofruar dhe natyrën e lëndës dhe sa ishte ajo e kuptueshme për studentët. Në pyetjen e drejtuar institucioneve në pyetësorin elektronik se a kanë organizuar institucionet ndonjë trajnim për stafin akademik për mësimin online, shumica e institucioneve kanë deklaruar se trajnime për stafin janë mbajtur, megjithatë vetëm një pjesë e vogël e tyre kanë deklaruar se ato trajnime janë fokusuar në metodologjinë e mësimit dhe në mësuesit. Shumica e institucioneve janë përgjigjur se trajnimet janë mbajtur nga Zyrat e TI-së për përdorimin e platformave elektronike si dhe janë hartuar udhëzues dhe video udhëzuese.

## Nga 15 përgjigje të pranura nga IAL-të



VETËM 4

INSTITUCIONE KANË DEKLARUAR SE KANË MBAJTUR TRAJNIM PËR STAFIN AKADEMIK QË LIDHET ME ASPEKTIN E MËSIMIT DHE METODOLOGJINË E MËSIMDHËNIES



Nga përgjigjet pozitive, njëri institucion ka deklaruar se ka trajnuar gjithë stafin akademik,



njëri IAL ka deklaruar se ka trajnuar gjithsej

13


STAF AKADEMIK



njëri IAL ka deklaruar se ka trajnuar

75

STAF AKADEMIK



dhe nga institucioni i katërt nuk është deklaruar numri i stafit të trajnuar.

Një aspekt të cilit iu kushtua pak ose thuaja aspak vëmendje nga IAL-të, por edhe nga institucionet shtetërore, është aspekti i shëndetit mendor të studentëve. Për momentin, mungon një analizë e gjerë e efekteve të pandemisë COVID-19 në arsimin e lartë në Kosovë, e cila do të nxjerr në pah përvojat e IAL-ve në kohë të pandemisë, vështirësitë e hasura të stafit akademik dhe studentëve si dhe efektet që ka shkaktuar izolimi në aspektin social dhe emocional të studentëve. Megjithatë, një studim për efektet e pandemisë COVID-19 tek studentët është bërë nga departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (Hyseni Duraku

dhe Hoxha, 2020)<sup>8</sup>, i cili analizoi përjetimet e studentëve gjatë mësimin online. Shumica e studentëve raportuan nivele të moderuara të stresit të perceptuar dhe ankth të lehtë psikologjik dhe somatik. Studentët zbuluan se angazhimi në mësimin online u mundësoi atyre që të largonin vëmendjen nga pandemia, ndërsa mbështetja emocionale nga mësimdhënësit ua lehtësoi atyre që të përballëshin me këtë periudhë. Sidoqoftë, mungesa e vëmendjes dhe e përqendrimit, ulja e motivimit për të ndjekur ligjëratat dhe për të mësuar, disponueshmëria e kufizuar e hapësirës në shtëpi, shpërqendrimi nga familja dhe marrja e detyrave të shumta gjatë mbylljes ishin sfidat kryesore me të cilat përballëshin studentët gjatë mësimin online.

Përveç procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, pandemia ndikoi edhe në intensitetin e aktiviteteve hulumtuese në IAL, kryesisht në bashkëpunimet në projekte ndërkombëtare me universitetet evropiane dhe më gjerë. U pezulluan konferencat dhe simpoziumet shkencore të planifikuara më herët të cilat mundësojnë promovimin e punës shkencore të stafit akademik nga Kosova, posaçërisht të shkencëtarëve të rinj. Pandemia ka ndikuar edhe në proceset e bashkëpunimit ndërkombëtar për shkak të pezullimit të plotë të udhëtimeve gjatë vitit 2020. Por, me konsolidimin e organizimit të aktiviteteve të arsimit të lartë në formë digjitale, filluan edhe organizimet e konferencave dhe takimeve tjera në këtë formë që mundësoi rikthimin e komunikimit në mes të stafit akademik të vendeve të ndryshme dhe shkëmbimin e përvojave të mësimin në distancë, ku morën pjesë edhe IAL-të nga Kosova.

Pas përfundimit të vitit akademik 2019/2020 në formë digjitale, IAL-ët të cilat ofrojnë programe në fushat e shkencave të mjekësisë, shkencave teknike, atyre të natyrës dhe të bujqësisë, filluan vitin e ri akademik 2020/21 me mësim të kombinuar. Duke respektuar në mënyrë rigorozë masat për mbajtjen e distancës, vendosjen e maskave dhe përdorimin e dezinfektuesve të duarve, pjesët praktike-eksperimentale të mësimin dhe provimet u organizuan në hapësira të fakulteteve përkatëse.

<sup>8</sup> [https://www.researchgate.net/publication/341654819\\_Ndikimi\\_i\\_COVID-19\\_ne\\_arsimin\\_e\\_larte\\_Studim\\_i\\_bashkeveprimimit\\_ne\\_mes\\_te\\_shendetit\\_mendor\\_te\\_studenteve\\_qendrimet\\_ndaj\\_te\\_mesuarit\\_online\\_aftesite\\_e\\_te\\_mesuarit\\_dhe\\_ndryshimet\\_ne\\_jeten\\_e\\_studenteve](https://www.researchgate.net/publication/341654819_Ndikimi_i_COVID-19_ne_arsimin_e_larte_Studim_i_bashkeveprimimit_ne_mes_te_shendetit_mendor_te_studenteve_qendrimet_ndaj_te_mesuarit_online_aftesite_e_te_mesuarit_dhe_ndryshimet_ne_jeten_e_studenteve)

Përkundrejt sfidave të cilat kanë shoqëruar procesin mësimor i cili është realizuar në formën online, institucionet e arsimit të lartë kanë numëruar edhe aspektet pozitive të tij.

Përparësitë e mësimit online sipas përgjigjeve në pyetësor përfshijnë:

- Ruajtja e shëndetit të shoqërisë në kohë pandemie;
- Fleksibiliteti në organizimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve;
- Menaxhimi më efektiv i kohës për shkak të mos udhëtimit;
- Zbritja e shpenzimeve për studentët;
- Mundësia e organizimit të ligjëratave me profesorë të huaj me kosto të vogël;
- Avancimi i njohurive teknologjike nga stafi dhe studentët.



